



Kontrolli i Lartë i Shtetit



UDHËZUESI PËR VLERËSIMIN

SISTEMI I MENAXHIMIT TË CILËSISË SË AUDITIMIT

2025

PËRGATITI:

**DEPARTAMENTI I METODOLOGJISË, PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE
ZHVILLIMIT PROFESIONAL**

Vlerësimi i Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në Auditim (SoAQM)

ISSAI 140, në kërkesën organizative nr. 6 kërkon që SAI të vlerësojë dhe të arrijë një përfundim për sistemin e menaxhimit të cilësisë në auditim (SoAQM). Për këtë aspekt të sistemit, në paragrafin 70 të ISSAI 140 vlerësimi thuhet se:

- Personi ose personat të cilëve u është caktuar përgjegjësia dhe llogaridhënia për sistemin e menaxhimit të cilësisë duhet të vlerësojnë dhe të arrijnë një përfundim mbi këtë sistem.

Vlerësimi duhet të mbulojë një periudhë të përcaktuar dhe të kryhet të paktën një herë në vit.


Sipas ISSAI 140 personi/personat ngarkuar me përgjegjësinë dhe llogaridhënien përfundimtare mbi funksionimin e sistemit është titullari i institucionit suprem të auditimit. Në kontekstin e Kontrollit të Lartë të Shtetit përgjegjësia e vlerësimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë është kompetencë e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Sipas materialit shpjegues të ISSAI 140, titullari i institucionit suprem të auditimit gjatë procesit të vlerësimit mund të ndihmohet apo asistohet nga individë të tjerë apo grupe ad hoc, si për shembull nga grupi i punës për monitorimin dhe përmirësimin, apo edhe ekspertë të jashtëm, për kryerjen e procesit të vlerësimit. Megjithatë, duhet theksuar se, sipas standardit, përgjegjësia përfundimtare mbetet përsëri tek titullari i institucionit.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, çdo vit përcakton personin apo personat të cilët do të asistojnë në kryerjen e procesit të vlerësimit.

Procesi i vlerësimit është një proces i brendshëm i institucionit dhe rezultatet e tij duhet të shërbejnë për të përmirësuar sistemin, përveçse kur kërkohet ndryshe nga kuadri ligjor e rregullator i SAI. Vlerësimi në kontekstin e ISSAI 140 nënkupton vlerësimin e të gjithë komponentëve të parashikuar nga ISSAI 140, komponentëve organizativ dhe komponentëve që nuk i përkasin proceseve, si më poshtë:

- Procesi i Menaxhimit të Riskut të Cilësisë;
- Qeverisja dhe Lidërshipi;
- Kërkesat Etike Përkatëse;
- Pranimi, Nisja dhe Vijimi i auditimeve;
- Kryerja e Angazhimeve të auditimit;
- Burimet;
- Informimi dhe Komunikimi;
- Procesi i monitorimit dhe përmirësimit.



Për të kryer procesin e vlerësimit personi ose personat të caktuar përgjegjës për sistemin e menaxhimit të cilësisë mund të marrin në konsideratë informacionet dhe rezultatet që rrjedhin nga:

- procesi i vlerësimit të riskut për menaxhimin e cilësisë të SAI-t, përfshirë objektivat e cilësisë, risqet e cilësisë, si dhe përgjigjet ndaj këtyre risqeve (pa përjashtuar këtu edhe shkallën në të cilën përgjigjet adresojnë këto rreziqe);
- rezultatet e procesit të monitorimit dhe ndërhyrjet përmirësuese, përfshirë këtu edhe:
 - i. pikat e forta të identifikuar në projektimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë;
 - ii. rëndësinë dhe përhapjen e mangësive të identifikuar dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivit të sistemit të menaxhimit të cilësisë;
 - iii. nëse janë projektuar dhe zbatuar masa përmirësues nga SAI dhe nëse masat e marra deri në momentin e vlerësimit kanë rezultuar efektive; dhe
 - iv. nëse ndikimi i mangësive të identifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë është korrigjuar në mënyrë të përshtatshme, si për shembull nëse janë ndërmarrë veprime të mëtjshme sipas nevojës.
- Ligjet, rregulloret apo faktorë të tjerë të zbatueshëm që mund të krijojnë rrethana kur është e përshtatshme që konkluzioni mbi efektivitetin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të komunikohet me palët e jashtme.

Forma e Vlerësimit

Vlerësimi hartohet në formën e një konkluzioni dhe miratohet me Vendim të Kryetarit të KLSH – së, sipas formatit të paraqitur në Aneksin 2. ISSAI 140 në paragrafin 73 parashikon se konkluzioni mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë së auditimit mund të marrë një nga tre format e mëposhtme:

- a) *sistemi i menaxhimit të cilësisë i ofron SAI – t siguri të arsyeshme që objektivat e SoAQM - së po arrihen;*
- b) *përveç çështjeve që lidhen me mangësi të identifikuar që kanë një ndikim të rëndë, por jo të përhapur në hartimin, zbatimin dhe funksionimin e tij, sistemi i menaxhimit të cilësisë i ofron SAI – t siguri të arsyeshme që objektivat e SoAQM - së po arrihen;*
- c) *sistemi i menaxhimit të cilësisë nuk i ofron SAI – t siguri të arsyeshme që objektivat e SoAQM - së po arrihen.*

Personi/personat përgjegjës për të asistuar Kryetarin e KLSH – në gjatë procesit të vlerësimit, duhet të mbledhin dhe të vendosin në dispozicion të titullarit informacionin e nevojshëm mbi të cilin do të kryhet vlerësimi. Konkluzioni mbi sistemin e menaxhimit të cilësisë mund të përfshijë ose të plotësohet me gjetje dhe rekomandime.

Frekuenca e Vlerësimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të kryejë çdo vit procesin e vlerësimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë së auditimit në përputhje me kërkesat e ISSAI 140.

Procedurat për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së auditimit

Personi/personat përgjegjës për të asistuar përgjatë procesit të vlerësimit duhet të mbledhin të gjithë informacionet e nevojshme mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë për periudhën përkatëse të vlerësimit me qëllimi evidentimin e mangësive të sistemit që janë evidentuar përgjatë periudhës referuese. Informacioni i mbledhur sintetizohet sipas formatit të përcaktuar në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzuesi duke ndjekur procedurat shpjeguar në vijim.

Procedurat e nevojshme që duhen kryer gjatë procesit të vlerësimit përfshijnë:

1. Listimin e të gjitha mangësive të identifikuar

Personi/personat përgjegjës për të asistuar përgjatë procesit të vlerësimit grumbullojnë të gjitha mangësitë e identifikuar gjatë procesit të monitorimit, si dhe çdo iniciative tjetër vlerësuese e ndërmarrë nga institucioni (qoftë kjo vetëvlerësimi sipas kornizës së PMF – së, peer review nga homologët, raporte monitorimi të strategjisë institucionale apo strategjive të tjera sektoriale të cilat identifikojnë pika të dobëta në funksionimin e institucionit, etj). Mangësitë e identifikuar listohen në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzuesi.

2. Vlerësimi i rëndësisë dhe përhapjes së mangësive në nivel individual.

Në vijim të identifikimit dhe listimit të mangësive të identifikuar në formatin përkatës të aneksit 1, personi/personat përgjegjës duhet të shqyrtojnë rëndësinë e secilës prej mangësive të identifikuar duke evidentuar nëse dhe si secila prej tyre ndikon në arritjen e një ose më shumë objektivave të cilësisë. Në vijim kryet vlerësimi i përhapjes së mangësive, duke marrë në konsideratë shkallën e ndikimit që secila prej tyre ka. Vlerësimi i rëndësisë dhe përhapjes së mangësive të konsideruara individualisht në këtë fazë, është paraprak, për të orientuar titullarin në gjykimin e tij mbi to.

3. Përcaktimi nëse janë dhënë masa përmirësuese për të adresuar mangësitë.

Në këtë fazë personi/personat përgjegjës duhet të evidentojnë nëse, për çdo mangësi të identifikuar: janë hartuar masa përmirësuese efektive; nuk janë identifikuar masa përmirësuese efektive: apo nuk janë parashikuar masa përmirësuese. Ky informacion plotësohet në formatin e përcaktuar në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzuesi. Edhe në këtë fazë vlerësimi i masave përmirësuese është paraprak për të orientuar dhe asistuar titullarin në vendimmarrje.

4. Vlerësimi nëse ndikimet e mangësive janë korrigjuar.

Përgjithësisht, ky proces kërkon që, në prezencë të masave përmirësuese efektive të identifikuar dhe zbatuara të vlerësohet nëse ato kanë sjell si rezultat: korrigjimin e mangësisë; mangësia nuk është korrigjuar; masa nuk kanë sjell asnjë efekt.

Në rastet kur nuk janë identifikuar dhe zbatuar masa përmirësuese efektive apo nuk janë parashikuar masa përmirësuese, vlerësuesi mund të përdorë këtë informacion si një tregues të nevojës për përmirësimin e vet komponentit të monitorimit.

Duhet pasur parasysh se, në disa raste masat përmirësuese mund të kërkojnë më shumë kohë për t'u zbatuar, ndaj në momentin e vlerësimit efektet e tyre mund të mos jenë materializuar ende. Në këto raste, KLSH duhet të rivlerësojë nëse kërkojnë veprime shtesë.

5. Vlerësimi i rëndësisë dhe përhapjes së mangësive në mënyrë të agreguar.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të secilës mangësi në drejtim të rëndësisë dhe përhapjes, përfshirë këtu edhe vlerësimin e masave përmirësuese dhe ndikimin e tyre në sistem, mund të ndodhë që mangësitë, individualisht, të mos jenë të rënda ose të përhapura, por të kombinuara të kenë efekt të rëndë dhe/ose të përhapur në të gjithë sistemin e menaxhimit të cilësisë së auditimit. Procesi i monitorimit dhe përmirësimit zakonisht duhet të sigurojë informacion për këtë qëllim. Prandaj, duhen konsideruar mangësitë e sistemit edhe në nivel të agreguar. Personi/personat përgjegjës për të asistuar Kryetarin e KLSH - së në këtë fazë të procesit i propozojnë atij rezultatin e vlerësimit të mangësive në nivel të agreguar. Është kompetencë e titullarit vendimmarrja mbi këtë vlerësim.

6. Përfundimi mbi rezultatet e vlerësimit dhe identifikimi i veprimeve të mëtejshme.

Nëse në nivel individual dhe të agreguar, mangësitë nuk janë të rënda dhe të përhapura, atëherë konkluzioni i vlerësimit duhet të shprehet si më poshtë:

“Sistemi i menaxhimit të cilësisë së auditimit në ofron KLSH një siguri të arsyeshme që objektivat e sistemit po arrihen.

Ky konkluzion nuk përjashton nevojën për hartimin e veprimet/masave shtesë për të adresuar ndikimin e pakorrigjuar të mangësive, nëse ka të tilla. Në rast se ka mangësi të cilat kanë rezultuar të pakorrigjuara, atëherë veprimet përmirësuese pasuese bëhen pjesë e vlerësimit.

Nëse ndikimi i mangësive në nivel të agreguar është i rëndë por jo i përhapur, atëherë konkluzioni i vlerësimit duhet të shprehet si më poshtë:

“Përveç çështjeve që lidhen me mangësitë e identifikuar që kanë një ndikim të rëndë, por jo të përhapur, sistemi i menaxhimit të cilësisë së auditimit në KLSH ofron një siguri të arsyeshme që objektivat e sistemit po arrihen.”

Në këtë rast, pjesë e këtij vlerësimi duhet të jenë edhe veprimet/masat përmirësuese të planifikuara me qëllim korrigjimin e situatës

Nëse ndikimi i mangësive në nivel të agreguar është i rëndë dhe i përhapur, atëherë konkluzioni i vlerësimit duhet të shprehet si më poshtë:

“Ekziston një nevojë thelbësore që KLSH të adresojë mangësitë e identifikuar në hartimin, zbatimin dhe/ose funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së auditimit, në mënyrë që ky sistem t’i ofrojë KLSH - së një siguri të arsyeshme që objektivat e tij po arrihen.”

Nëse vlerësimi rezulton sipas konkluzionit të dytë apo të tretë, atëherë nga KLSH nevojitet që të ndërmerret iniciativa më thelbësore, si për shembull ndryshime në politikat dhe procedurat ekzistuese, ndërmarrja e masave përmirësuese dhe/ose korrigjimi i efekteve të mangësive. KLSH duhet të marrë masa për të përshpejtuar zbatimin e masave ekzistuese ose të zgjerojë mbulimin e funksionit të monitorimit për të siguruar informacion të mjaftueshëm për vlerësimet e ardhshme.

Procedurat e vlerësimit mund të pasqyrojnë konsideratat e mëposhtme:

✓ **Rëndësia dhe përhapja e mangësive të identifikuara në sistemin e menaxhimit të cilësisë së auditimit.**

Rëndësia i referohet madhësisë/peshës që zënë mangësitë, ndërsa përhapja i referohet shkallës së ndikimit të tyre. Procesi i monitorimit dhe përmirësimit ofron informacion të mjaftueshëm për këtë qëllim.

✓ **Ekzistenca dhe/ose efektiviteti i masave përmirësuese për adresimin e mangësive.**

Monitorimi nuk siguron vetëm identifikimin e mangësive, por edhe masat përmirësuese për t'i adresuar ato dhe ndikimin e tyre, si dhe shkakun e tyre. Vlerësimi duhet të marrë parasysh nëse masat përmirësuese të ofruara nga funksioni i monitorimit janë të mjaftueshme për të adresuar mangësitë, gjë që reflekton edhe në vlerësimin e komponentit të monitorimit.

✓ **Korrigjimi i ndikimit të mangësive të identifikuara.**

Disa nga rekomandimet e monitorimit të përmendura më sipër mund të jenë tashmë zbatuar për të korrigjuar ndikimin e mangësive. Duhet theksuar se një sistem efektiv i menaxhimit të cilësisë së auditimit adreson gjithashtu çështjet aktuale (ndikimin e tanishëm) të shkaktuar nga mangësitë.

Ekzistenca e mangësive tregon se një komponent ose grup komponentësh të sistemit nuk funksionon siç është parashikuar ose nuk është hartuar në mënyrë të përshtatshme. Mosarritja e një ose më shumë objektivave të cilësisë është tregues i mangësive në sistem. Për shembull, KLSH mund të vërejë se këto mangësi nuk do të ekzistonin nëse komponenti i vlerësimit të riskut do të kishte identifikuar kërcënimet e dukshme përpara se ato të materializoheshin në një mangësi. Prandaj, mund të jetë e nevojshme rishikimi i politikave dhe procedurave të komponentin të vlerësimit të riskut për të identifikuar nevojën për përmirësim.

Llojet e Përfundimeve

Lloji i Konkluzionit	Përshkrimi	Masa të Mëtejshme
Sistemi ofron siguri të arsyeshme	Të gjitha komponentët funksionojnë siç duhet; të metat janë të vogla ose të korrigjuara.	Mbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve.
Mangësi të rënda por jo të përhapura	Mangësitë kanë ndikim të rëndë, por nuk prekin të gjithë sistemin. Nevojiten masa për të korrigjuar efektet.	Rishikim i politikave; përmirësim i Kornizës së Kompetencave dhe angazhim i ekspertëve.
Sistemi nuk ofron siguri të arsyeshme	Mangësitë janë të rënda dhe të përhapura; sistemi nuk	Ristrukturim i plotë i sistemit; hartim i politikave

	arrin objektivat dhe kërkon përmirësime thelbësore.	dhe procedurave të reja; ndërhyrje emergjente.
--	---	--

ANEKSI 1



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
PERSONI/PERSONAT PËRGJEGJËS PËR TË ASISTUAR NË VLERËSIMIN E
SISTEMIT**

Nr. _____, Prot ,

Tiranë, __.__.202_

MIRATOHET

ARBEN SHEHU

KRYETAR

**VLERËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË CILËSISË SË
AUDITIMIT VITI 202_**

Mangësitë		Vlerësimi sipas çdo mangësie		Masat Përmirësuese/Korrigjuese	Korrigjimi i ndikimit të mangësive të identifikuara
Nr.	Përshkrim	E Rëndë	E Përhapur		
		<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Me masa përmirësuese efektive Specifiko masat: _____ <input type="checkbox"/> Masat Përmirësuese nuk janë efektive <input type="checkbox"/> Nuk janë parashikuar masa përmirësuese	<input type="checkbox"/> Korrigjuar Specifiko si: _____ <input type="checkbox"/> Pa korrigjuar <input type="checkbox"/> Nuk ka ndikim në sistem
		<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Me masa përmirësuese efektive Specifiko masat: _____ <input type="checkbox"/> Masat Përmirësuese nuk janë efektive	<input type="checkbox"/> Korrigjuar Specifiko si: _____ <input type="checkbox"/> Pa korrigjuar

			<input type="checkbox"/> Nuk janë parashikuar masa përmirësuese	<input type="checkbox"/> Nuk ka ndikim në sistem
		<input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Jo Shpjegimi:	<input type="checkbox"/> Me masa përmirësuese efektive Specifiko masat: _____ <input type="checkbox"/> Masat Përmirësuese nuk janë efektive <input type="checkbox"/> Nuk janë parashikuar masa përmirësuese	<input type="checkbox"/> Korrigjuar Specifiko si: _____ <input type="checkbox"/> Pa korrigjuar <input type="checkbox"/> Nuk ka ndikim në sistem
Vlerësimi në nivel të agreguar:		<input type="checkbox"/> I Rëndë <input type="checkbox"/> I Përhapur		
Konkluzioni i propozuar nga personi/personat përgjegjës për të asistuar në vlerësimin e sistemit:				
<input type="checkbox"/> Sistemi i menaxhimit të cilësisë së auditimit i ofron KLSH - së një siguri të arsyeshme që objektivat e sistemit po arrihen. (Shënim: Janë ende të nevojshme veprime për të adresuar ndikimin e pakorrigjuar të mangësive, nëse ka të tilla.) Veprimet e planifikuara: _____				
<input type="checkbox"/> Përveç çështjeve që lidhen me mangësitë e identifikuara që kanë një ndikim të rëndë, por jo të përhapur, sistemi i menaxhimit të cilësisë së auditimit në KLSH ofron një siguri të arsyeshme që objektivat e sistemit po arrihen. Veprimet e planifikuara: _____				
<input type="checkbox"/> Ekziston një nevojë thelbësore që KLSH të adresojë mangësitë e identifikuara në hartimin, zbatimin dhe/ose funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së auditimit, në mënyrë që ky sistem t'i ofrojë KLSH - së një siguri të arsyeshme që objektivat e tij po arrihen. Veprimet e planifikuara: _____				



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHETIT
KRYETARI

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.202_

V E N D I M

Nr. ____, Datë _____.202_

PËR
MIRATIMIN E VLERËSIMIT VJETOR TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË
CILËSISË NË KLSH, PËR VITIN 202_

Në zbatim të kërkesës organizative nr. 6 “Vlerësimi dhe Konkluzioni mbi Efektivitetin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë” të ISSAI 140, Menaxhimi i Cilësisë për Institucionet Supreme të Auditimit, në Kontrollin e Lartë të Shtetit, për vitin 202_ ka funksionuar sistemi i menaxhimit të cilësisë. Ky sistem është ngritur bazuar në dokumentin “Politika e Menaxhimit të Cilësisë në KLSH” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH – së nr. 128, datë 01.07.2024, nëpërmjet të cilit janë vendosur procesi e menaxhimit të riskut të cilësisë, procesi i monitorimit dhe përmirësimit në nivel organizativ dhe në nivel auditimi, si dhe procesi i vlerësimit të sistemit.

Përgjatë vitit 202_, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka zbatuar Udhëzuesin për Menaxhimin e Riskut të Cilësisë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH – së nr. ____, datë _____.202_, Udhëzuesin për Monitorimin dhe Përmirësimin miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH – së nr. ____, datë _____.202_, si dhe Udhëzuesin për Vlerësimin e Sistemit. miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH – së nr. ____, datë _____.202_. Në përfundim të procesit të menaxhimit të riskut dhe procesit të monitorimit dhe përmirësimit në nivel organizativ dhe në nivel auditimi, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka nisur procesin e vlerësimit të sistemit. Me shkresën nr. ____, datë _____.202_, është caktuar grupi përgjegjës për të asistuar në përmbushjen e procesit të vlerësimit dhe arritjes së konkluzionit mbi efektivitetin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në KLSH.

Pasi u njoha me vlerësimin e mangësive të identifikuara të sistemit në nivel individual dhe të agreguar të propozuar nga grupi me anëtarë: _____, sipas formatit përkatës të parashikuar në Aneksin 1, të Udhëzuesit të Vlerësimit të Sistemit, si dhe mbështetur në

nenin 25, të Ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj vlerësimin dhe konkluzionin mbi efektivitetin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në KLSH si më poshtë:

a. Sistemi i menaxhimit të cilësisë së auditimit i ofron KLSH - së një siguri të arsyeshme që objektivat e sistemit po arrihen.

b. Përveç çështjeve që lidhen me mangësitë e identifikuar që kanë një ndikim të rëndë, por jo të përhapur, sistemi i menaxhimit të cilësisë së auditimit në KLSH ofron një siguri të arsyeshme që objektivat e sistemit po arrihen.

c. Ekziston një nevojë thelbësore që KLSH të adresojë mangësitë e identifikuar në hartimin, zbatimin dhe/ose funksionimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë së auditimit, në mënyrë që ky sistem t’i ofrojë KLSH - së një siguri të arsyeshme që objektivat e tij po arrihen.

II. Të miratoj planin e veprimeve përmirësuese të planifikuara (bashkëlidhur këtij vendimi) për korrigjimin e mangësive të identifikuar të cilat kanë rezultuar ende të pa korrigjuara.

Personi/Personat përgjegjës për të asistuar në Vlerësim

Emër Mbiemër

K R Y E T A R

Arben Shehu